



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I BASENIT UJOR VJOSË

Nr 12/8 Prot

Vlorë, më 29.07. 2022.

VENDIM

Nr. 10 , datë 21.07.2022

PËR
MIRATIMIN E LEJES PËR PËRDORIM BURIMI UJOR NËNTOKËSOR PËR
QËLLIME INDUSTRIALE,
ME VENDNDODHJE: FSHATI MAJKOSH, BASHKIA TEPELENË, QARKU
GJIROKASTËR

Në mbështetje të pikës 2, nenit 50, të ligjit nr.111/2012, “Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore”, të ndryshuar, vendimit nr.550, datë 15.7.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e formularëve të kërkesës për miratimin, në parim, për dhënien me koncesion të përdorimit të burimit ujqor, e lejes/autorizimit për përdorim burimi ujqor, veprimtari ndërtimore në brigje, veprimtari në shtratin e burimit ujqor, shkarkime të lëngshme, përdorimin dhe ripërdorimin e ujërave të përdorura, të ndotura, të dokumenteve shoqëruese, të procedurës së shqyrtimit e të vendimmarrjes dhe të afateve të vlefshmërisë së tyre”, me propozimin e Agjencisë së Menaxhimit të Burimeve Ujqore, Këshilli i Basenit Ujqor Vjosë,

V E N D O S I:

1. Miratimin e lejes për përdorim burimi ujqor nëntokësor për qëllime industriale, me vendndodhje: Rruga Nacionale Tepelenë-Memaliaj, km 1, Fshati Majkosh, Bashkia Tepelenë, Qarku Gjirokastër.

2. Treguesit paraprak janë si më poshtë:

Akuiferi që kërkohet të shfrytëzohet: Akuiferi aluvial i Vjosës

Koordinatat e vendndodhjes së shpimit (KRGJSH)

X=501129.43; Y=4465093.40; Z=120 m.m.n.d

Qëllimi i përdorimit të ujit: Për qëllime industriale në fabrikën e betonit dhe asfalteve

Prurja e ujit të kërkuar: $Q=0.5$ l/sek

Prurja mesatare vjetore: $Q_{mes-vjet}=3.0$ l/sek

Koordinatat e vendndodhjes së pikës ku do të shfrytëzohet uji (KRGJSH)

$X=501062.51$; $Y=4464774.73$; $Z=149$ m.m.n.d

Koordinatat e pikës së shkarkimit (KRGJSH)

$X=501093.93$; $Y=4464851.22$; $Z=142$ m.m.n.d

Prurja që shkarkohet: $Q= 0.15$ l/s

3. Burimi ujqor të përdoret vetëm për qëllimin e kërkuar (për qëllime industriale në fabrikën e betonit dhe asfalteve), dhe të mos përdoret për larje të inerteve lumore nëse subjekti nuk ka një leje aktive të shfrytëzimit të këtyre të fundit.
4. Ngarkohet Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujqore për zbatimin e këtij vendimi.



K R Y E T A R

FLAMUR MAMAJ

Flamur Mamaj